

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Nr. i prokurimit	KEK-24-6324-1-1-1
Nr. i brendshëm	KEKC-24-193-111

Sa i përket tenderit për: **Furnizimi me shirita transportues gomë-pëlhurë**

ANKESË

Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Bahri Asllani B.I - N.T.SH "EKOINVEST"**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 511/9, Prishtinë, 10 000**

Numri Telefonit: **044/303-068**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Eron Asllani**

Adresa elektronike: **info@ekoinvest.co**

Data e parashtrimit të ankesës: **24.05.2025**

Nënshkrimi dhe vula:

A blue circular stamp with the text "Ndërmarrja Tregtare Shërbyese" around the top edge, "EKOINVEST" in the center, and "PRISHTINË" around the bottom edge. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- B05- Njoftimi për kontrate- 04.06.2024
- Afati për dorëzim të tenderit- 06.08.2024
- Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;
- Procesverbal i hapjes së ofertave- 06.08.2024
- B58- Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- 21.11.2024
- Paraqitja e Kërkesës për Rishqyrtim- 26.11.2024
- Përgjigje në Kërkesës për Rishqyrtim – 02.12.2024
- Vendimi i OSHP nr. 2024/1204: 25.02.2025
- B58- Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: 06.05.2025;
- Letër Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm: 06.05.2025;
- Paraqitja e Kërkesës për Rishqyrtim- 12.05.2025
- Përgjigje në Kërkesës për Rishqyrtim – 15.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Hapja në mënyrë elektronike e ofertave është bere me datën 06.08.2024 - Nuk kemi marre pjese në hapje fizike të ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>			Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	----	--------------------------

Me datën 06.05.2025 përmes Platformës së E-prokurimit kemi pranuar Formularin për Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Me datën 12.05.2025 përmes platformës së E- Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – KËRPOKATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a. . Me datën 15.05.2025 përmes platformës së E- Prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues që Kërkesën tone për Rishqyrtim e konsideron si të pa bazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përfundim të këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 - Dosja e Tenderit

Neni 29 - Variantet e specifikimeve teknike

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, nuk ka zbatuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, nr. 2024/1204, të datës 25.02.2025, vendim i cili aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me shirita transportues gome-pelhure” me numër prokurimit KEK-24-13521-1-1-5 e kthen në rivlerësim. Ky vendim në faqe nr. 9 (shih me poshte foto nga Dëshmia 1 – Vendimi i OSHP) obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë procesit të rivlerësimit të sigurohej nëse ky operator ka ofruar variante në ofertën e tij.

Andaj PSH obligon AK që gjatë rivlerësimit të konsultohet me njësinë e kërkesës dhe ekspert profesional për vlerësimin e ofertës, me qëllim që të vërtetohet se OE i rekomanduar a ka ofruar sipas kërkesave të vendosura në DT dhe po ashtu të sigurohet se OE i rekomanduar a ka ofruar variante apo jo në këtë rast, të cilat do të ishin në kundërshtim me DT.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues duhet të miratohet si pjesërisht e bazur Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues – “KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES” sh.a të datës 21.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me shirita transportues gomë-pëlhurë” me nr. të prokurimit: KEK-24-6324-1-1-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Se OE i rekomanduar -“**Xani Inex**”, ka ofruar 2 variante të ofertës (pavarësisht se variantet nuk janë autorizuar në Dosjen e Tenderit) e vërteton edhe vete AK përmes pyetjeve sqaruese nga komisioni i tretë vlerësues ku ka kërkuar nga OE i rekomanduar të përcaktojë se cili dokument (variant) duhet marrë për bazë gjatë vlerësimit të ofertës së saj (Shih me poshtë foto nga Dëshmia 2 – Pyetjet Sqaruese gjatë fazës së vlerësimit drejtuar OE të rekomanduar për kontratë -“Xani Inex”,).

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

1. Në ofertën e juaj ju keni dorëzuar katalogun e prodhuesit të shiritave transportues dhe përshkrimin teknik të prodhuesit me karakteristika teknike të kërkuara dhe të ofruara.
Na konfirmon se cili dokument (katalogu apo përshkrimi teknik i prodhuesit) të merret për bazë gjatë vlerësimit të ofertës së juaj.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh brenda 2 ditë nga data e kësaj kërkesë, përmes platformës.

Ky veprim i AK bie ndesh me Dosjen e Tenderit e cila ne kete Aktivitet te Prokurimit nuk autorizon variantet (Shih me poshte foto nga Deshmia 3 – Dosja e Tenderit).

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
Variantet	4.1	Variante autorizohen: Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i dërgesës është: Depo e DPQ, Obiliq

Bazuar ne qasjen ne dokumentacion te mundësuar nga AK pas vendimi te fundit te datës: 06.05.2025, nuk ka asnjë dëshmi apo veprim të ndërmarrë nga AK në funksion të zbatimit te obligimeve te dala nga Vendimi i Panelit Shqyrtues te OSHP-së nr. 2024/1204.

Ne përgjigje te Kërkesës për Rishqyrtim nga Vendimi i AK te datës 06.05.2025, AK refuzon pretendimet tona te faktuara duke tentuar te kamufloje shkeljet e tij me nje aktivitet tjeter te prokurimit (shih me poshtë foto nga Dëshmia 4 – Përgjigje ne Kërkesën për Rishqyrtim).

<p>Kerkesa e Panelit Shqyrtues te OSHP nuk eshte marr fare per baze nga komisoni i ri- vleresimit ne vertetësi se OE i rekomanduar per kontrat a ka afruar varianta.</p> <p>Pergjigje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni ne ri-vlerësimin e ofertës se O.E. Xani -Inex përpos dokumentacionit ne ofertë të ofruar TECHNICAL PARAMETERS CONVEYOR të vulosur nga prodhuesi e ka merr për bazë edhe kontratën emergjente të lidhur me te njëjtin operator po ashtu edhe prodhuesi i njëjtë me titull Furnizimi me shirita transportues gomë-pëlhurë me numër KEK-24-13521-1-1-5 dhe numër të mbrëmshëm KEKC-24-435-115 të datës 09.01.2025 me nr. 355. <p>Komisioni shqyrton Certifikatat e kualitetit për te gjitha tipet e shiritave të ofruara ne rastin e liferimit.</p>
--

Shpërfillja dhe moszbatimi i obligimeve te OSHP-se drejtuar AK për verifikimin e varianteve ne ofertën e OE te rekomanduar, është dëshmi shtese se ne këtë Aktivitet te Prokurimit AK ka favorizuar një OE te pa-përgjegjshëm pasi që:

- Ka kthyer ne ri-vlerësim aktivitetin 2 here radhazi derisa komisioni i trete e rekomandon për kontrate një OE te papërgjegjshëm
- Nuk zbaton obligimet e vendimit te OSHP për verifikimin e varianteve gjate ri-vlerësimit pas vendimit te OSHP.

Me poshtë dëshmi te veprimeve te AK mbi favorizimin e OE te papërgjegjshëm:

Bazuar në qasjen e dokumentacionit, kemi vërejtur se janë ndërmarrë veprime të shumta për të manipuluar procesin e vlerësimit, me qëllim që një operator ekonomik i **pa përgjegjshëm**, i cili ka dështuar të ofrojë një ofertë teknike të plotë dhe të përgjegjshme, të shpallet në mënyrë të padrejtë si operator ekonomik i përgjegjshëm.

Nga dokumentacioni, është e qartë se vlerësimi fillestar i kryer nga Komisioni i Parë i Vlerësimit është realizuar në mënyrë profesionale, duke zbatuar në përpikëri dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky vlerësim është përmbyllur me një raport të detajuar ku operatori ekonomik “XANI

Inex” është shpallur i papërgjegjshëm për mos përmbushjen e specifikimeve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Papërgjegjshmëria është dokumentuar dhe argumentuar qartë në Raportin e Vlerësimit. Ndërkohë, ne si operator ekonomik kemi qenë unanimitisht të rekomanduar si të përgjegjshëm, me çmimin më të ulët të ofertës (Dëshmia 5 – Raporti i Vlerësimit 1).

Kthimi i procesit për rivlerësim ka ndodhur si pasojë e manipulimit që i është bërë Drejtorit të Zyrës së Prokurimit nga ana e Menaxherit të Departamentit për Furnizime pranë Zyrës së Prokurimit. Ky i fundit, pa paraqitur asnjë arsye apo argument të vlefshëm, dhe mbi bazën e një veprimi të njëanshëm, ka kërkuar që procesi të kthehet për rivlerësim. Me poshtë pjese nga Dëshmia 1 – Raporti i vlerësimit

Vërejtje përmbyllëse të Udhëheqësit të Departamentit të Furnizimit pranë ZEP-it lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:	
<i>Të kthehet në rivlerësim</i>	
Menaxheri i Departamentit për furnizime pranë ZEP-it:	
Emri dhe Mbiemri:	Emin Tmava
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	11/09/2024

Pas kthimit për rivlerësim dhe krahasimit të përsëritur të ofertave konkurruese, janë vlerësuar vetëm **dy oferta si teknikisht të përgjegjshme**, të cilat përmbushnin të gjitha kriteret dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT). Vlerësimi është bërë nga dy anëtarë të Komisionit Teknik, inxhinierë të fushës së mihjes për shiritat transportues. Ndërsa anëtari i tretë i komisionit vlerësues që vije nga prokurimi ka votuar kundër. Në këtë vlerësim, kompania jonë është shpallur përsëri e përgjegjshme me çmimin më të ulët me shumicë votash, ndërsa kompania **Xani Inex** është shpallur përsëri e papërgjegjshme për mos përmbushje të specifikimeve teknike për mallrat e ofruara.

Pavarësisht kësaj, anëtari i Komisionit nga **Zyra e Prokurimit (ZEP)**, edhe pse nuk është inxhinier i fushës përkatëse, nuk është pajtuar me rekomandimin e Komisionit Teknik. Ai është thirrur në argumentin se “vlerësimi nuk është bërë në pajtim me nenin 1 dhe 6 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore për sqarime, sipas neneve 59 dhe 72 të LPP-së”. (Dëshmia 6 – Raporti i Vlerësimit 2). Megjithatë, ai nuk ka kërkuar që të bëhen sqarime shtesë nga operatori që ishte shpallur teknikisht i papërgjegjshëm, por vetëm ka votuar kundër.

Për më tepër, Menaxheri i Departamentit për Furnizime pranë ZEP-it, përsëri në mënyrë të njëanshme, nuk ka kërkuar nga Komisioni i Rivlerësimit që të kërkohen sqarime shtesë, por thjesht ka dhënë mendimin e tij dhe ka kërkuar rikthimin e procesit për rivlerësim të serishëm.

Vërejtje përmbylëse të Udhëheqësit të Departamentit të Furnizimit pran ZEP-it lidhur me vlerësimin dhe propozimet e komisionit vlerësues:	
<i>Menaxheri i Departamentit të Furnizimit pran ZEP-it</i>	
Menaxheri i Departamentit të Furnizimit pran ZEP-it:	Emri dhe Mbiemri: <u>Emin Tmava</u>
Nënshkrimi:	<u><i>[Signature]</i></u>
Data:	<u>28/10/2020</u>

Siç duket, ky veprim i përsëritur nga zyrtari i lartë përmendur i ZEP është i njëanshëm dhe i qëllimshëm, pasi nuk ka arritur që përmes komisionit të dyte të vlerësimit të shpallë të përgjegjshëm OE “Xani Inex” ndoshta për shkak se konsideron se komisioni është **"i padëgjueshëm"**. Për këtë arsye, ai kërkon përsëri rikthimin në rivlerësim, një veprim skandaloz që për herë të parë ndodh të kërkohej për herë të dytë rivlerësimi nga një Menaxher i Departamentit të Furnizimit pran ZEP. Qëllimi duket të jetë gjetja e një komisioni teknik "të dëgjueshëm," i cili do ta shpallë të përgjegjshëm kompaninë **“Xani Inex”**, pavarësisht se sipas katalogut të ofruar, ajo nuk i përmbush Specifikimet Teknike të Dosjes së Tenderit.

Për të arritur këtë qëllim, formohet një komision i tretë, kësaj here jo nga personel profesional i fushës së shiritave transportues, por nga një anëtar i **Divizionit të Mihjes-Hinizimit** dhe një tjetër nga **Divizioni i Gjenerimit**. Këta anëtarë kanë njohuri minimale në lidhje me specifikimet teknike të shiritave transportues, por duket se kriteri kryesor ka qenë që të jenë "të dëgjueshëm".

Tani, komisioni i tretë vlerësues (i cilësuar tashmë si "i dëgjueshëm") ka kërkuar nga kompania **“Xani Inex”** të përcaktojë se cili dokument (variant) duhet marrë për bazë gjatë vlerësimit të ofertës së saj. Shih pyetjen sqaruese me poshtë marrë nga **Dëshmia 2 – Pyetjet Sqaruese**.

<p>Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ne ofertën e juaj ju keni dorëzuar katalogun e prodhuesit të shiritave transportues dhe përshkrimin teknik të prodhuesit me karakteristika teknike të kërkuara dhe të ofruara. Na konfirmon se cili dokument (katalogu apo përshkrimi teknik i prodhuesit) të merret për bazë gjatë vlerësimit të ofertës së juaj. <p>Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh brenda 2 ditë nga data e kësaj kërkesë, përmes platformës.</p>
--

Pyetja e lartë cekur mund të behet vetëm në rastet kur në Dosjen e Tenderit (DT) autorizohen variantet, siç përcaktohet në **Nenin 29, pika 2** të Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 29
Variantet e specifikimeve teknike

1. Nëse kontrata do ti shpërblehet tenderuesit ekonomikisht më të favorshëm, autoritetet kontraktuese mund të autorizojë që tenderuesit të paraqesin variantet.
2. Autoriteti kontraktues duhet të tregoj në dosjen e tenderit nëse ata autorizojnë variante apo jo; variantet nuk do të autorizohen pa këtë indikacion.
3. Autoritetet kontraktuese që autorizojnë variantet duhet të deklarojnë në dosjen e tenderit kërkesat minimale për tu plotësuar nga variantet dhe ndonjë kërkesë specifike për prezantimin e tyre.

Për më tepër, ky komision ka shkelur gjithashtu edhe **pikën 4.1** të Ftesës për Dorëzimin e Tenderit (FDT), e cila është shumë e qartë dhe thekson se variantet nuk autorizohen në këtë dosje të tenderit (**Dëshmia 3 – Dosja e Tenderit, pika 4.1**). Kërkesa për të përcaktuar një variant të tillë bie në kundërshtim të plotë me dokumentacionin dhe rregulloret në fuqi, duke dëmtuar procesin e rregullt të vlerësimit dhe favorizuar në mënyrë të padrejtë një operator ekonomik të caktuar.

Raste të tilla dëshmojnë qartë praktikën e mëhershme të konsoliduar për eliminimin e ofertave të ngjashme me 2 variante. Veprimi i komisionit aktual për të pranuar një ofertë të tillë përbën një devijim të dukshëm dhe të pajustificueshëm nga praktikat dhe standardet e mëparshme.

Po ashtu, ky komision vlerësues bie ndesh me vlerësimet dhe vendimet e aktiviteteve të mëparshme të prokurimit. Për ilustrim, më poshtë paraqesim dy shembuj konkretë ku është marrë vendim eliminues në raste të ngjashme:

1. **Projekti me titull “Furnizim me Pirunar të Ri”**, numër **KEK 23 6598-1-1-1**: Në këtë projekt, ne u shpallëm fitues me datën **24.08.2023** (**Dëshmia 7**) duke ofruar çmimin më të lirë. Pas një **Kërkese për Rishqyrtim**, aktiviteti u kthye në rivlerësim. Gjatë kësaj faze, oferta jonë u shpall e papërgjegjshme me arsyetimin se specifikimet teknike të paraqitura në katalogun tonë nuk ishin identike me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT), edhe pse oferta e jonë përmbante specifikimet e vulosura dhe të nënshkruara nga prodhuesi (**Dëshmia 8**). Eliminimi u dokumentua me një letër standarde që përmban këto të dhëna (**Dëshmia 9**).
2. **Projekti me titull “Riparimi i Stacionit Ngasës (Konvejerit) të Shiriti Transportues D3.2”**, numër prokurimi **KEK 22-3365-5-2-1**: Në këtë projekt, ne plotësuam ofertën në formë tabelare, duke krahasuar specifikimet tona (shtylla e djathtë) me ato të përcaktuara në DT (shtylla e majtë). Kjo ofertë ishte vulosur dhe nënshkruar nga të dy anëtarët e konsorciumit (Shih me poshtë).

		Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
26	Pajisjet e akubateris me inverter 110 VDC/ 230VAC 4. Tipi: 3FSMC 400VAC/110VDC/30A 5. Tipi: BNU-9 MEASURING AND CONTROL UNIT 6. Tipi: DXN 110-2M	Prodhuksi: EL-UR Tipi: BNU-9, DXN 110-2M, 3FSMC 400-30 Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
27	Kamere industriale	Prodhuksi: FELCO Tipi: IBP331-1ER; IBP3BBAP-ES Vendi i origjinës: US Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
28	Monitor industrial për kamerë + 17"	Prodhuksi: SIEMENS Tipi: 6AV78622BE000AA0 Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
29	Detektor tymi me alarm	Prodhuksi: INIM Tipi: ID100 Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
30	Detektor zjarri me alarm	Prodhuksi: INIM Tipi: ID200 Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
31	T3N 250 TMD200-2000 3P FF Automatic circuit breaker, 200A 3-pole 36kA AUX T1...T6 1Q 1SY Auxiliary contact blok for T1...T6 MCCB (INO aux. contact+INO fault contact) TMAXES T2 Front extended spread terminals for T1...T6 MCCB	Prodhuksi: ABB Tipi: ISDA051368R1; ISDA066897R1; ISDA068058R1 Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
32	Të gjitha elementet përcjellëse (bulonat, dadot, regallat, gypat etj etj) duhet të jenë nga OE	N/A
33	Dritaret (xhamat) në kabinë të operatorit	N/A
34	Të gjitha pajisjet të integrohen në PLC ekzistuese dhe të komunikojnë	N/A
35	Demontimi dhe montimi i të gjitha pajisjeve elektrike	N/A
36	Te riparohet ndriçimi në komplet konvejerin.	Prodhuksi: SCHREDER Tipi: MY1 LED, OMNISTAR Vendi i origjinës: EU Katalog nga prodhuesi ISO Standardi: 9001
37	Të përmisohen (revidohen) skemat me pajisjet e reja që montohen, të dorëzohen në hard copy dhe	N/A

B17 Dosja e Tenderit – Punë – Procedurë e Hapur



Për projektin e lartë cekur, ju lutem shihni me poshtë arsyen e eliminimit (shkëputur nga Dëshmia 10):

Për Pozicionin 16, nuk keni ofruar katalog apo pjesë të katalogut si dhe specifika teknike të prodhuesit siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
Për Pozicionin 22, në dosjen e tenderit dhe gjatë fazës tenderuese me pyetje sqaruese është kërkuar vetëm të servicohen klimat ekzistuese, ju keni ofruar klima të reja GREE nga Kina.
Për Pozicionin 26, në dosjen e tenderit është kërkuar BNU-9, ju në tabelën plotësuese të Specifikimit teknik i detyrueshëm deklaron se ofron BNU-9 kurse në katalog ofroni BNU-7.
Për Pozicionin 36, ju keni ofruar produktin SCHREDER të Serbisë kurse origjinën e keni deklaruar EU.

Ndërsa më poshtë është katalogu i ofruar nga ne për projektin në fjalë dhe arsyen e eliminimit në fjalë:

[HR](#) | [EN](#)


[HOME](#) [PRODUCTS](#) [ABOUT US](#) [CONTACT](#)

Single-phase rectifiers
Three-phase rectifiers
Inverters
DC/DC converters
Solar
AC voltage stabilizers
Power supply systems, AC and DC voltage distribution
Battery forming rectifiers
Frequency converters
Test equipment
Battery monitoring unit

Contact:
Tel./fax: +385 1 3886 669
Mob.: 098/ 9197-888
e-mail: el.ur@el-ur.com

Battery monitoring unit

BNU (battery monitoring unit): rectifier and battery monitoring



Measures rectifier's current and battery voltage, detects battery earthing then limits the charge current, regulates battery charging voltage depending on the temperature (temperature compensation) and protects battery from deep discharge.

One BNU monitoring unit supervises max. four parallel working rectifiers.

Suitable for installation on distribution box door (small dimensions and weight).

Për këtë projekt, arsyetimi për eliminimin tonë (shkëputur nga Dëshmia 10) u bazua në ndryshimet midis specifikimeve të ofruara dhe atyre të katalogut, gjë që përfundimisht u aprovua nga OSHP me datën 10.11.2022, në vendimin me numër 452/22 (Dëshmia 11), ku ankesa jonë u refuzua si e pabazuar.

Përfundimisht kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas shqyrtimit të provave materiale të prezantuara me këtë ankesë të aprovojë plotësisht atë duke dhënë:

V E N D I M

APROVOHET Kërkesa e Operatorit Ekonomike N.T.SH EKOINVEST (Bahri Asllani B.I.) – Prishtinë për Rishqyrtimin e VENDIMIT të Autoritetit Kontraktues me nr. prokurimit KEK-24-6324-1-1-1(KEK-24-193-111) titulli i kontratës i dhënë nga Autoriteti Kontraktues: “Furnizimi me shirita transportues gomë-pëlhurë”. ANULOHET (PRISHET) VENDIMI i atakuar me këtë kërkesë (i përshkruar si më lartë), dhe qështja të kthehet në RIVLERESIM për vendosje meritore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Nuk janë definuar deri me tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate- 24.06.2024
2. Procesverbali i hapjes se Ofertave
3. NJOFTIM PER VENDIMIN E AK_06.05.2025
4. Dëshmia 1_Vendimi OSHP -2024/1204
5. Dëshmia 2_ Pyetjet Sqaruese gjate fazës se vlerësimit drejtuar OE te rekomanduar për kontrate - "Xani Inex"
6. Dëshmia 3_Dosja e Tenderit -Shqip, pika 4.1
7. Dëshmia 4_Përgjigje ne Kërkesën për Rishqyrtim KEKC-24-193-111 nga AK_15.05.2025
8. Dëshmia 5_ Raporti i vlerësimit 1
9. Dëshmia 6_ Raporti i ri-vlerësimit 2
10. Dëshmia 7_ Vendimi për shpallje fitues
11. Dëshmia 8_ Specifikimet e ofruara nga prodhuesi
12. Dëshmia 9_ Eliminimi për shkak se ne katalog nuk përmbushen specifikat
13. Dëshmia 10_ Eliminimi për shkak se ne katalog nuk përmbushen specifikat
14. Dëshmia 11_ Vendimi i OSHP nr. 452-22

Dëshmi Transaksioni

Proof of Transaction



Raiffeisen
BANK

Member of RBI Group

Të dhënat e urdhëruesit / Orderer details

Emri i urdhëruesit / Ordering Customer	BAHRI ASLLANI B.I.
Numri i llogarisë së urdhëruesit / Ordering account number	1501001010933350
Referenca e urdhëruesit / Ordering reference number	FT25144XQTVJ
Adresa / Address	AGIM RAMADANI NN AGIM RAMADANI C1/9

Të dhënat e përfituesit / Beneficiary details

Emri i përfituesit / Beneficiary name	Organi Shqyrtues i Prokurorimit / Procurement Review Body
Numri i llogarisë së përfituesit / Beneficiary account number	1501001010282577

Të dhënat e transaksionit / Transaction details

Shuma / Amount	5,000.00
Monedha / Currency	EUR
Kursi i këmbimit / Exchange rate	1.0000
Përshkrimi i pagesës / Payment description	Tarifa e Ankimit për aktivitetin: Furnizimi me shirita transportues gome-pelhure - KEK-24-6324-1-1-1, U
Komisioni / Commission	0
Data / Date	24/05/2025
Kanali i pagesës / Payment channel	imBanking
Statusi i pagesës / Payment status	Ekzekutuar / Executed



Rifreskoni kontaktet tuaja! Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm përmes numrit të telefonit dhe adresës suaj të saktë, ne mund t'ju mbajmë të informuar për çdo ofertë, ndryshim apo produkt/shërbim bankar.

Update your personal and contact details (phone number, address) if they changed since your last update, by visiting the nearest branch of Raiffeisen Bank. Updated contact details allow us to keep in touch with you in real time on new offers, important notice and our products&services.

Kontakti +383 38 222 222 • info@raiffeisen-kosovo.com • www.raiffeisen-kosovo.com

Adresa: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., str. Robert Doll #99 10000 Prishtinë, Kosovë • Swift: RBKOKPR • IBAN: XK05



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAÇANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



PPQDD11111111111H

Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

Bahri Asllani B.I - N.T.SH Ekoinvest, RR. Agim Ramadani, Aktash C1/9, 10000 Prishtine

Përshkrimi
Opis
Description

Furnizimi me shirita transportues gomë-pëlhurë

Numri i prokurimit
Broj nabavke
Procurement number

KEK-24-6324-1-1-1

Shuma / Iznos
Amount

€ 5000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 240525

Me fjalë / Rečima
In words

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1000430070005756

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa ndërlihet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.